



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:157991
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626136

Cap.nr.1744/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.M. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë D.R. dhe F.G., avokatë nga Prishtina, kundër debitorës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës, Organi Shpronësues në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike përmbartimore-kompensim shpronësimi, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të debitorës, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.413/23 të datës 04.10.2023, jashtë seance me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të debitorës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës, Organi Shpronësues me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.413/23 i datës 04.10.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.413/23 të datës 04.10.2023, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës, Organi Shpronësues në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin mbi caktimin e përmbartimit P.nr.299/23 të datës 26.06.2023, i organit përmbartues-përmbartuesit privat Destan Bujupaj. Në pikën dy, ka obliguar debitorin e përmbartimit Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës, Organi Shpronësues në Prishtinë, që të autorizuarve të kreditorit të përmbartimit t'ia kompensoj shumën prej 487.00 euro, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i debitorës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të shfuqizohet urdhri përbarimor P.nr.299/23 dt.26.06.2023 dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori përmes të autorizuarve të tij, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përbarues-aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, C.nr.68/13 të datës 18.03.2019, i plotfuqishëm nga data 09.02.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 19.04.2023. Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin e kërkuar nga kreditori me urdhrin P.nr.299/23 të datës 26.06.2023, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 07.07.2023, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 14.07.2023. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, organi përbarues e cakton përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit përbarues, organi përbarues e cakton përbarimin vetëm në bazë të titullit përbarues sipas dispozitë së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, si dokument përbarues është: “*vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese*”. Në rastin konkret titull përbarues është aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, C.nr.68/13 të datës 18.03.2019, i plotfuqishëm nga data 09.02.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 19.04.2023. Dokument përbarues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së është përcaktuar se: “*vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur para gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit*”, dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me aktvendim siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranoj pretendimin ankimor se kreditori nuk ka aplikuar në Departamentin e Shpronësimit për tërheqjen e mjeteve, pasi debitori në rastin konkret sipas dokumentit përmbarues ka pasur afatin partitiv prej 15 ditësh që të bëjë përmbushjen vullnetare ndërsa nga plotfuqishmëria e aktvendimit deri në inicimin e procedurës përmbarimore ka kaluar kohë e konsiderueshëm, në të cilën debitori ka mundur që të bëjë përmbushjen vullnetare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Cap.nr.1744/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti